



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:105752

Datë: 07.07.2021

Numri i dokumentit: 01967490

PKR.nr.1024/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Alban Ajvazi, me bashkëpunëtoren profesionale Kristina Shtufi, në çështjen penale, kundër të akuzuarit B. M., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1076/17a, të datës 29.06.2017, pas mbajtjes së seancës fillestare me datën 22.06.2021, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Departamentit për Krime të Rënda Armend Hamiti, i akuzuari B. M., me datë 22.06.2021, mori dhe publikisht të njëjtën ditë shpalli, ndërsa me datë **07.07.2021**, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. M., i biri i D., nënës M., e gjinisë M., i lindur më datë ..., në P..., me adresë vendbanimi në rr. "...", nr..., lagja A..., në P..., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Për shkak se:

I

Me datë 16.11.2016, rreth orës 17:40, në Prishtinë, në rrugën "...", i pandehuri ka mbajtur në pronësi pa autorizim, një sprej i llojit "pro tec", mjet i cili nuk lejohet në posedim të paautorizuar, duke shkelur Ligjin pe zbatueshëm mbi armën.

Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 62, 73, dhe nenit 374 par.1 të KPRK-ës, e lidhur me nenet 365 dhe 366 të KPP-së, të pandehurit i;

SHQIPTON

- I. **DËNIM me gjobë në lartësi prej 400 euro (katërqind euro)**, të cilën shumë obligohet ta paguaj brenda afatit prej tre (3) muajve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në tre këste të barabarta, më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
- I. **OBLIGOHET** i pandehuri, që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 euro, si dhe shumën prej 50 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimi, në tërësi shumën prej 80€ (tetëdhjetë euro), të gjitha në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

- II. DËNIM PLOTËSUES- Marrjen e sendeve Gjykata, në mbështetje të nenit 282 par.1 e 2 të KPP-së, si dhe neneve 62 dhe 374 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nxjerrë këtë:

URDHËR - URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve si ne vijim:

- III. Sprei i llojit “pro tec”, pronë e të pandehuri.
- IV. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo armë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1076/17a, të datës 29.06.2017, ka akuzuar B. M., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale Lëndim i lehtë truporë nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

Departamenti i Përgjithshëm i kësaj Gjykate, duke u bazua në dispozitat e nenit 19 par.1 të Ligjit për Gjykatat e lidhur me nenin 22 par.1 pika 1.75 të KPP-ës, këtë çështje penale me datën 09.11.2020, e ka deleguar pranë– Departamenti për Krime të Rënda, për shqyrtim dhe vendosje, për shkak të kompetencës lëndore lidhur me këtë veprë penale.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datën 22.06.2021 dhe pasi që i akuzuari B. M., deklaroi se pranon fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ndërsa sa i përket veprën penale Lëndim i lehtë truporë nga neni 188 par.2 të KPRK-së, deklarohet i pafajshëm.

Gjykata duke u gjendur në një situatë të tillë merr Aktvendimin PKR.nr.1024/20 dt:22.06.2021, për Veçim të procedurës sa i përket veprës penale Lëndim i lehtë truporë nga neni 188 par.2 të KPRK-së,

Prokurori i shtetit lidhur me deklarin e të akuzuarit për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë sa i përket pikës II të aktakuzës, pasi që është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Po ashtu i akuzuari është deklaruar se i din pasojat dhe përfitimet nga pranimi i fajësisë. Andaj ky pranim është në përputhje me dispozitat ligjore dhe i propozoj gjykatës që të njëjtën ta pranoj dhe me rastin e marrjes së vendimit ta ketë parasysht pranimin e fajësisë për këtë veprë penale, ta merre rrethanë lehtësuese.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e kësaj veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj veprë penale, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit B. M., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin e shpalli fajtor, dhe i shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Konfiskimi:

Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2 të KPP-ës dhe neneve 62 dhe 374 par.3 KPRK-ës, ndaj të pandehurit ka shqiptuar edhe dënimin plotësues ashtu që, ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armës; Sprei i llojit “pro tec”.

- Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurin B. M., ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar, dashjen direkte të pandehurit tek kjo vepër penale, shkallën e përgjegjësisë penale, faktin se kjo natyrë e veprave penale janë më të shpeshtuara në Kosovë, rrezikshmërinë që paraqesin këto vepra penale dhe faktin se i njëjti këtë armë e ka mbajtur me vete në automjetin e tij.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë, në raport me gjykatën dhe palët. Ndërsa, si rrethana posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë.

Gjykata, vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të pandehurit, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e të pandehurit dhe rrethanat tjera që kemi cekur është adekuat dhe ne si gjykatë jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat tjerë, që të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 dhe 453 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr.05/L-036.

Vendimi mbi konfiskimin, është marrë në bazë të nenit 62 par 3 të KPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2019:105752, 07.07.2021

G j y q t a r i

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.